



Tirane 20/08/2024

Drejtuar: Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Raporti fakteve te gjetura mbi Auditimin Ligjor të Fondeve të Përfuara dhe të Shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023 nga Partia Progresi Demokratik.

Ne kemi kryer procedurat e rena dakort me ju ne kontraten me Nr.2227 Prot datë 27.07.2024 e lidhu rndermjet paleve, qe do te pershkruhen me poshte, lidhur me fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2023 nga Partia Progresi Demokratik.

Procedurat u kryen vetem per t'ju ndihmuar juve qe te percaktoni fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2023 nga Partia Progresi Demokratik te cilat jane permbledhur me poshte :

1. Ne morem nga KQZ kontratenNr.2227 Prot datë 27.07.2024 per kryerjen e auditimit ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2023 nga Partia Progresi Demokratik.

2. Ne derguam me poste Rekomande me Lajmërim ne menyre te perseritur me dt.18.08.2024 “ Kerkese per dergim te dhenash Partia Progresi Demokratik në adresen; Tirane .

Ne raportojme gjetjet tona si me poshte :

Ne lidhje me piken 2 ne konstatuam se : Kërkesa iu kthye derguesit sepse adresa ishte e pagjetur. Bashkengjitur dokumenti i postes.

Si konkluzion per shkak se procedurat e mesiperme nuk perbejne auditim dhe as rishikim te bere ne perputhje me Standartet Nderkombetarete Auditimit ne nuk mund te shprehim asnje opinion per fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2023 nga Partia Progresi Demokratik.

SHOQËRIA AUDITUESE “ACA MARGJEKA” SH.P.K
(Audit, Consulting & Accounting Company)
Partner Angazhimi

Shkelzen MARGJEKA, Auditues Ligjor

Tiranë, me 20.08.2024





K E R K E S E
DREJTUAR: Partia Progresi Demokratik

TIRANE

Te nderuar Drejtues

Une, Shkelzen Margjeka , Auditues Ligjor, Partner Angazhimi i shoqërisë Aca Margjeka shpk në përputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi(Cituar më poshtë) si dhe kontraten me Nr.2227 Prot datë 27.07.2024 e lidhur ndermjet Shkelzen Margjeka dhe KQZ, për të audituar fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2023 nga partia Juaj, kerkojme te ne vini ne dispozicion gjithë dokumentacionin justifikues bashke me Pasqyrat Financiare te Partisë Suaj për vitin 2023.

Auditimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin e cituar në vijim:

Ligji 10019 date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
Ligji Per Partite Politike Nr.8580 date 17/02/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374 date 10/02/2011, ligjin nr. 17/2014 date 20/02/2014 ligjin nr. 25/2014, date 25/09/2014, ligjin nr.90/2017

Ligji Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor Organizimin e profesionit te Audituesit Ligjor dhe Kontablit te Miratuar, i ndryshuar me Ligjin 10297 date 08/07/2010.

Ligji 25/2018 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”i ndryshuar’


Vendimi nr.152date 11.04.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për formatet e standartizuara të raporteve të auditimit që do të dorëzohen ne KQZ.

i. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit që përdoren në Shqiperi

Standardi Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat io Fitimpruresë (SKK në QIE)

Dergon: **Shkelzen Margjeka**
Pr. 3 vellezerit Kondi
Tirane



Mod. E-10

KTHEHET	
I PANJOHUR	<input type="checkbox"/>
LARGUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PAMJAFTUESHME	<input checked="" type="checkbox"/>
KANDRYSHUAR ADRESE	<input type="checkbox"/>
OBJEKT I PA KERKUAR	<input type="checkbox"/>
REFUZUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PASAKTE	<input type="checkbox"/>

Merr: Partia Progresi Demokratik
Tirane